

Mars 2024 | Nr. 36

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

ANKESAT E BËJNË SISTEMIN MË TË PËRGJEGJSHËM





ANKESAT E BËJNË SISTEMIN MË TË PËRGJEGJSHËM

Në Shkurt të këtij viti, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Lartë të Drejtësisë shënoi 4 vite jetë, duke hyrë në fazën e konsolidimit të praktikave më të mira të punës. Mes detyrave funksionale, asistencë dhe informimi i qytetarëve që drejtohen vijon të mbetet një prioritet i pandryshueshëm për institucionin.

Numri i qytetarëve që i drejtohen Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të paraqitur ankesë ndaj gjyqtarëve e prokurorëve është në rritje. Kjo është shenjë besimi tek institucioni, e cila merret me shumë përgjegjshmëri së pari nga sektori përgjegjës, i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, e më tej nga i gjithë ekipi i Zyrës së Inspektorit të

Për statistikë, gjatë vitit 2023, Zyra e Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka asistuar dhe informuar nëpërmjet takimeve dhe linjës telefonike në lidhje me pretendimet/ankimet e tyre për magjistratët, mesatarisht dy qytetarë në ditë.

Konkretisht, janë realizuar 241 takime me qytetarë, mbi bazën e kërkesave me shkrim, të kërkesave më anë të komunikimit me telefon, si dhe pa përcaktim të mëparshëm. Gjatë takimeve, në çdo rast nëpunësit përgjegjës kanë dëgjuar pretendimet e qytetarëve, duke asistuar/informuar për paqartësitë, në lidhje

Numri i qytetarëve që i drejtohen Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të paraqitur ankesë ndaj gjyqtarëve e prokurorëve është në rritje. Kjo është shenjë besimi tek institucioni, e cila merret me shumë përgjegjshmëri së pari nga sektori përgjegjës, ai i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, e më tej nga i gjithë ekipi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

me të drejtat e tyre për t'u ankuar. 188 qytetarë/subjekte të interesuar janë asistuar përmes numrit zyrtar të institucionit, të cilët kryesisht kanë kërkuar informacion mbi fazën në të cilën ndodhen ankesat, mënyrën se si pranohen, si procedohet me paraqitjen e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve të tyre, etj.

Ekipi i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun pret qytetarët e interesuar çdo ditë punë nga ora 09.00-14.00.





KLP NUK PRANON KËRKESËN E ILD PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATES A.P.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka pranuar në mbledhjen e sotme kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj magjstrates A.P., me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Hetimi disiplinor nga ILD kishte nisur pas administrimit nga Prokurori i Përgjithshëm, të praktikës së hetimit disiplinor për prokuroren A.P., për disa fakte, që lidhen me shkelje të rregullave të sjelljes në komunikimin me drejtuesin e prokurorisë, kolegët e tjerë magjistratë, si dhe personelin e administratës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për të cilën është informuar Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për sjellje jo etike dhe joprofesionale nga prokurorja gjatë ushtrimit të funksionit.

Hetimi disiplinor ka konkluduar se shkelja kategorizohet si “shkelje e lehtë disiplinore”, pasi

nuk rezulton që të ketë sjellë pasojë, nuk lidhet me veprimtarinë profesionale të magjstrates, por është e natyrës që magjistratja duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.

Përveç mbrojtjes së interesit publik, masa disiplinore përmbush edhe dy qëllime parandaluese: parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë, që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

KLP rrëzoi propozimin e ILD për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje konfidenciale”, për prokuroren A.P., të parashikuar nga neni 106 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

MARSI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Mars** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **62 ankesa**, nga të cilat 61 janë paraqitur nga qytetarë dhe 1 ankesë nga institucion.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Mars 2024**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
<p>19 vendime nga 30 ankesa të shqyrtuara, konkretisht:</p> <p>⇒ 11 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar ;</p> <p>⇒ 8 vendime arkivimi pas verifikimit</p>	<p>⇒ 1 vendim verifikimi</p>	<p>⇒ 1 kërkesë për procedim disiplinor për 1 prokuror</p>

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Mars 2024** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **11 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Mars 2024, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 22 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 12 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve,

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Mars 2024**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **17 kërkesa për informacion**, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani**

@ild_albania · 4 Mar



📍 Ja si ka qenë ecuria e përpunimit javor të ankesave të administruara nga #ILD ⚖️

✅ 6037 të konfirmuara

✅ 5074 të trajtuara

✅ 885 në proces trajtimi

👉 Më shumë <http://www.ild.al>

? A keni patur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉

<https://ild.al/sq/ankete/>

💬 ↻ 2 ❤️ 1 Twitter

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani**

@ild_albania · 18 Mar



Të dhënat javore të përpunimit të ankesave në #ILD ⚖️

✅ 6045 të konfirmuara

✅ 5092 të trajtuara

✅ 895 në proces trajtimi

✅ 238 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar

✅ 108 magjistratë të hetuar

✅ 39 kërkesa për procedim disiplinor

Më shumë 👉 <http://www.ild.al>

💬 ↻ ❤️ 1 Twitter

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani**

@ild_albania · 11 Mar



📍 Ecuria e përpunimit javor të ankesave në #ILD ⚖️

✅ 6042 të konfirmuara

✅ 5084 të trajtuara

✅ 890 në proces trajtimi

✅ 240 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar

👉 Më shumë <http://www.ild.al>

? Keni patur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉

<https://ild.al/sq/ankete/>

**Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani**

@ild_albania · 25 Mar



📍 Si cdo të hënë ecuria e përpunimit javor të ankesave në #ILD ⚖️

✅ 6046 të konfirmuara

✅ 5092 të trajtuara

✅ 909 në proces trajtimi

👉 Më shumë

? A keni patur eksperiencë me ne? 🙌👉

<https://ild.al/sq/ankete/>

**Inspektori i Larte i Drejtesise A**

@ILD_Albania

Follow



Nga pritja e qytetarëve në #ILD 🙌 nga ekipi i Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun. #ankesa #informim #transparencë

[Translate post](#)



MARS 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)

